

BERDICA CEMENT sh.p.k.

**PASQYRAT FINANCIARE
SIPAS STANDARDEVE KOMBËTARE TË KONTABILITETIT
PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022**

Tabela e përmbajtjes

Pasqyrat financiare	
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	1
Pasqyra e pozicionit financiar.....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	3
Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare.....	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	
1. Historiku i Shoqërisë.....	8
2. Mjedisi operues.....	8
3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël.....	9
4. Vlerësime të rëndësishme të kontabilitetit dhe gjykime në zbatimin e politikave kontabël.....	14
5. Të ardhurat.....	15
6. Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit.....	15
7. Shpenzimet personeli.....	15
8. Shpenzime tatim fitimi.....	15
9. Aktivët afatgjatë materiale.....	17
10. Aktivët afatgjatë jomateriale.....	17
11. Llogaritë e arkëtueshme.....	17
12. Të tjera të arkëtueshme.....	18
13. Mjete monetare.....	18
14. Inventarët.....	18
15. Kapitali.....	19
16. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera.....	19
17. Tatime të pagueshme.....	19
18. Huamarrjet.....	19
19. Qira financiare.....	20
20. Menaxhimi i rrezikut financiar.....	20
21. Menaxhimi i kapitalit.....	23
22. Balanca dhe transaksione me palët e lidhura.....	23
23. Angazhime dhe aktive / detyrime të kushtëzuara.....	23
24. Ngjarje pas datës së raportimit.....	23

BERDICA CEMENT sh.p.k.
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBjes DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE
 (në lekë)

Pershkrimi i Elementeve	Shenime	Periudha nga 1 janari në:	
		31-12-22	31-12-21
TE ARDHURAT			
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	5	2,962,306,079	1,679,632,413
Ndryshime ne inventarin e produkteve te gateshme dhe PP			
Puna e kryer nga njesia ekonomike dhe e kapitalizuar			
Te ardhura nga shitja e aktiveve te qendrueshme			2,467,275
Totali i te ardhurave		2,962,306,079	1,682,099,687
SHPENZIMET			
Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme		(2,605,587,696)	(1,421,273,323)
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>		<i>(2,605,587,696)</i>	<i>(1,421,273,323)</i>
<i>Te tjera shpenzime</i>			
Kosto e punes	7	(50,625,794)	(36,996,592)
<i>Pagat e personelit</i>		<i>(43,670,567)</i>	<i>(31,880,243)</i>
<i>Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore</i>		<i>(6,955,227)</i>	<i>(5,116,349)</i>
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale			
Shpenzime Amortizimi dhe konsumi		(13,277,635)	(12,610,543)
Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	6	(123,013,796)	(86,151,401)
Totali i shpenzimeve (4 - 9)		(2,792,504,921)	(1,557,031,859)
Fitimi/ (Humbja) nga veprimtaria kryesore		169,801,158	125,067,828
Te ardhura te tjera			
<i>Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)</i>			
<i>Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)</i>			
<i>Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)</i>			
Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra			
Te ardhura dhe shpenzime financiare		(6,067,961)	(2,324,318)
Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi		(7,442,722)	(7,433,179)
Fitim/(humbjet) nga kursi i kembimit		1,374,761	5,108,861
Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare			
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
FITIMI/(HUMBJA) para tatimit		163,733,197	122,743,510
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin			
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin aktual	8	(25,819,310)	(19,240,444)
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin te shtyre		-	-
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin te pjesmarrjeve			
FITIM/(HUMBJA) neto e vitit financiar		137,913,887	103,503,066

Shënimet në faqet 8 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BERDICA CEMENT sh.p.k.
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE
 (në lekë)

Pershkrimi i Elementeve	Shenime	Periudha nga 1 janari në:	
		31-12-22	31-12-21
Fitimi/Humbja e vitit		137,913,887	103,503,066
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:</i>		-	-
<i>Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja</i>		-	-
<i>Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</i>		-	-
<i>Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare të mbajtura për shitje</i>		-	-
<i>Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet</i>		-	-
<i>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</i>		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		137,913,887	103,503,066
Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:			
<i>Pronarët e njësisë ekonomike mëmë</i>			
<i>Interesat jo-kontrolluese</i>			

BERDICA CEMENT sh.p.k.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

(në lekë)

AKTIVET	Shenime	Periudha nga 1 janari në:	
		31-12-22	31-12-21
AKTIVET AFATSHKURTERA			
Mjete Monetare			
Investime	13	8,471,256	27,735,864
<i>Në tituj pronësie të njëjësive ekonomike brenda grupit</i>			
<i>Aksionet e veta</i>			
<i>Te tjera Financiare</i>			
Totali 2			
Të drejta të arkëtueshme			
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	11	323,782,086	257,236,704
<i>Nga njesite ekonomike brenda grupit</i>			
<i>Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>			
<i>Te tjera (Llogari/kerkesa te tjera te arketueshme)</i>	12	50,925,845	32,927,207
<i>Te tjera (Teprica kreditore ne Dogane + paga te parapaguara)</i>	12	343,382	1,362,224
<i>Interes i llogaritur qira financiare</i>		81,907	179,933
<i>Parapagime per furnizime</i>			
<i>Te tjera</i>			
Totali 3		375,133,220	291,706,068
Inventari			
<i>Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</i>		-	380,383
<i>Prodhim ne proces</i>			
<i>Produkte te gatëshme</i>			
<i>Mallra per rishitje</i>	14	350,299,404	212,690,770
<i>Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)</i>			
<i>AAGJM të mbajtura për shitje</i>			
<i>Parapagime per inventar</i>		11,325,349	33,465,396
Totali 4		361,624,754	246,536,549
Shpenzime të shtyra		986,472	295,776
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara		-	-
TOTAL I AKTIVEVE AFATSHKURTERA (I)		746,215,701	566,274,257
AKTIVET AFATGJATA			
Aktive financiare			
<i>Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit</i>			
<i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit</i>			
<i>Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
<i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
<i>Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata</i>			
<i>Tituj të tjerë të huadhënies</i>			
Totali 1			
Aktive materiale	9		
<i>Toka</i>			
<i>Ndertesat</i>		51,780,663	53,975,153
<i>Aktive ne proces</i>		30,504,259	-
<i>Makineri dhe pajisje</i>		23,085,711	18,706,956
<i>Mjete transporti</i>		20,806,480	27,027,721
<i>Parapagime për aktive materiale dhe në proces</i>		77,169,135	
Totali 2		203,346,246	99,709,830
Aktivet biologjike			
Aktivet jomateriale	10	183,642	216,856
<i>Sofiëare</i>		183,642	216,856
<i>Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme</i>			
<i>Parapagime për AAJM</i>			
Totali 4			
Aktive tatimore të shtyra			
TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA (II)		203,529,888	99,926,686
TOTALI I AKTIVEVE (I+II)		949,745,589	666,200,944

Shënimet në faqet 8 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BERDICA CEMENT sh.p.k.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

(në lekë)

DETYRIMET DHE KAPITALI	Shenime	Periudha nga 1 janari në:	
		31-12-22	31-12-21
DERYRIMET AFATSHKURTER			
Detyrime afatshkurtra			
<i>Titujt e huamarrjes</i>			
<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë ASH</i>	18	86,703,563	81,982,289
<i>Arketime ne avance per porosi</i>		12,662,616	303,181
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	16	408,292,312	232,958,754
<i>Qira te pagueshme ASH</i>	19	617,615	748,185
<i>Te pagueshme ndaj ortakut (Dividend)</i>		72,488,371	-
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		-	26,800
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve</i>		-	26,800
<i>Detyrime tatimore</i>	17	3,729,632	4,033,124
<i>Te tjera</i>		-	-
Totali I		584,494,110	320,052,333
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara			
Të ardhura të shtyra			
Provizione			
TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTERA (I)		584,494,110	320,052,333
DETYRIMET AFATGJATA			
Detyrime afatgjata			
<i>Titujt e huamarrjes</i>			
<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	18	95,724,043	110,416,667
<i>Arketime ne avance per porosi</i>		-	-
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>		-	-
<i>Qira te pagueshme AGJ</i>	19	858,547	1,473,875
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit</i>		-	-
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		-	-
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve</i>		-	-
<i>Detyrime tatimore</i>		-	-
<i>Kreditore te tjere</i>		-	-
Totali I		96,582,590	111,890,541
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara			
Të ardhura të shtyra			
Provizione			
<i>Per pensionet</i>		-	-
<i>Te tjera</i>		-	-
Detyrime tatimore te shtyra		-	-
TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA (II)		96,582,590	111,890,541
TOTALI I DETYRIMEVE (I+II)		681,076,700	431,942,874
KAPITALI DHE REZERVAT			
<i>Kapitali i nenshkruar</i>	15	130,755,000	130,755,000
<i>Primi I aksionit</i>		-	-
<i>Rezerva rivleresimi</i>		-	-
<i>Rezerva ligjore</i>		-	-
<i>Rezerva statutore</i>		-	-
<i>Rezerva te tjera</i>		-	-
<i>Fitim/humbja e akumuluar</i>		-	-
<i>Fitim/humbja e vitit financiar</i>		137,913,887	103,503,066
TOTALI I KAPITALIT DHE REZERVAVE (III)		268,668,887	234,258,067
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)		949,745,589	666,200,941

Shënimet në faqet 8 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BERDICA CEMENT sh.p.k.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

(në lekë)

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga administratori i BERDICA CEMENT sh.p.k. dhe janë firmosur në emër të tij më 27.03.2023 nga:


Emrijeta Pemaj
Drejtor Financiar



BERDICA CEMENT SH.P.K.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
 (në lekë)

	Kapitali i nënshtuar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitimet/ (humbjet) e pasipendata	Fitim/(humbja) e periudhes	Totali
pozicioni financiar ne fillim 2021	261,510,000	87,981	28,063,406	80,250,005	-	369,911,392
Efekt i ndryshimeve ne politikat kontabile	-	-	-	-	-	-
Pozicioni financiar i rrddeklaruar ne fillim	261,510,000	87,981	28,063,406	80,250,005	-	369,911,392
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:	-	-	-	-	-	-
Fitim/(humbja) e periudhes	-	-	-	-	103,503,066	103,503,066
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-
Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura	-	-	-	-	-	-
drejtpendrejti ne kapital	-	-	-	-	-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	-	-	-	-	103,503,066	103,503,066
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:	-	-	-	-	-	-
Emetim i kapitalit të nënshtuar	(130,755,000)	-	-	-	-	(130,755,000)
Pakesim i kapitalit të nënshtuar	-	(87,981)	(28,063,406)	(80,250,005)	-	(108,401,392)
Dividende te shpendare	-	-	-	-	-	-
Krijimi rezervave	-	-	-	-	-	-
Te tjera	-	-	-	-	-	-
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	(130,755,000)	(87,981)	(28,063,406)	(80,250,005)	-	(239,156,392)
Pozicioni financiar ne fund 2021	130,755,000	-	-	-	103,503,066	234,258,066
Pozicioni financiar ne 1 Janar 2022	130,755,000	-	-	103,503,066	-	234,258,066
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:	-	-	-	-	-	-
Fitim/(humbja) e periudhes	-	-	-	-	137,913,887	137,913,887
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-
Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura	-	-	-	-	-	-
drejtpendrejti ne kapital	-	-	-	-	-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	-	-	-	-	137,913,887	137,913,887
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:	-	-	-	-	-	-
Emetim i kapitalit të nënshtuar	-	-	-	-	-	-
Kontribut ne natyre i kapitalit	-	-	-	(103,503,066)	-	103,503,066.21
Dividende te shpendare	-	-	-	-	-	-
Krijimi rezervave	-	-	-	-	-	-
Te tjera	-	-	-	-	-	-
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	-	-	-	(103,503,066)	-	103,503,066
Pozicioni financiar ne fund 2022	130,755,000	-	-	-	137,913,887	268,668,887

Shënimet në faqet 8 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BERDICA CEMENT sh.p.k.
PASQYRA E LËVIZJEVE TË MJETEVE MONETARE

(në lekë)

	Shenime	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhese
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:			
Fitimi/(Humbja) para tatimit e periudhes		163,733,197	122,743,510
<i>Rregullime per shpenzimet jo-monetare:</i>			
Shpenzimet financiare		7,442,718	
Shpenzime konsumi dhe amortizimi (Fitim)/humbja nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	9, 10	13,277,635	12,610,543
Interesa te fituara			2,218,273
Te tjera		(338,087)	
Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit			
Renie/(Rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera	11, 12	(84,117,847)	(57,254,678)
Renie/(Rritje) ne inventar	14	(115,088,205)	4,201,611
Rritje/(Renie) ne te pagueshme tregtare dhe te tjera	16, 17	188,129,516	(25,632,436)
Interes I paguar		(7,442,718)	
Tatim fitimi I paguar	8	(26,586,123)	(19,240,444)
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit		145,202,967	39,646,379
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit			
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	9, 10	(123,073,704)	(17,195,948)
Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale			
Pagesa per blerjen e investimeve te tjera			
Arketime nga shitja e investimeve te tjera			
Dividente te arketuar			
Interesa te arketuara			
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata biologjike			
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit		(123,073,704)	(17,195,948)
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit			
Arketime nga emetimi i kapitalit te nenshkruar			
Hua te arketuara	18	114,598,200	132,506,869
Pagesa e huave	18	(124,328,753)	
Qira financiare e pagueshme	19	(648,624)	
Dividende te paguar		(31,014,695)	(239,156,392)
Te tjera			
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit		(41,393,873)	(106,649,522)
Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to		(19,264,609)	(84,199,091)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	13	27,735,864	111,934,955
Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund	13	8,471,256	27,735,864

BERDICA CEMENT sh.p.k.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

1. Historiku i Shoqërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 për BERDICA CEMENT sh.p.k. ("Shoqëria").

Shoqëria është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me datë 21 Maj 2010, me numer unik identifikues L017245011 të regjistruar në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB).

Shoqëria zotërohet nga ortakët Behar Berdica 51% të pjesëve dhe Zyhdi Reshketa 49% të pjesëve.

Aktiviteti kryesor: Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërisë për 2022 është tregti me shumice e pakice e artikujve të ndryshëm ndertimi, çimento, hekur, artikuj industrial.

Adresa e regjistruar dhe vendndodhja e Shoqërisë: Adresa e regjistruar dhe vendndodhja e Shoqërisë është Xhafzotaj, z.k. 2574, nr.pasurie 162/106, Durrës, Shqipëri.

Monedha raportuese: Këto pasqyra financiare janë paraqitur në monedhën Lek ("ALL"), të parrumbullakosura, nëse nuk specifikohet ndryshe.

Numri i punonjësve të Shoqërisë në datën 31 dhjetor 2022 ishte 41.

2. Mjedisi operues

Republika e Shqipërisë shfaq disa karakteristika të një tregu në zhvillim. Ekonomia e saj është e brishtë dhe e ndjeshme ndaj zhvillimeve ekonomike rajonale. Kornizat ligjore, tatimore dhe rregullatore vazhdojnë të zhvillohen dhe janë subjekt i ndryshimeve dhe interpretimeve të ndryshme. Duke qenë një vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian ("BE"), sfida e tij legjislativë është t'i përmbahet kërkesave të BE-së për zgjerim.

Në mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë e shpalli shpërthimin e COVID-19 një pandemi globale. Në përgjigje të pandemisë, autoritetet e vendit zbatuan masa të shumta në përpjekje për të frenuar përhapjen dhe ndikimin e COVID-19, të tilla si ndalimet dhe kufizimet e udhëtimit, karantina, urdhrat e strehimit në vend dhe kufizimet në aktivitetin e biznesit, duke përfshirë mbylljet. Disa nga këto masa u lehtësuan më pas, megjithatë, që nga 31 dhjetori 2022, ekziston rreziku që autoritetet mund të vendosin kufizime shtesë në vitin 2023 si përgjigje ndaj varianteve të reja të mundshme të virusit.

Drejtimi po ndërmerr masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri të operacioneve të shoqërisë dhe për të mbështetur klientët dhe punonjësit e saj:

- Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit (BCM) dhe Contingency Plan për të siguruar aktivitetet e shoqërisë;
- Protokollin COVID-19 në vend dhe i ndjekur sipas rekomandimit të autoriteteve përkatëse;
- Pozicionet kryesore të identifikuara si të nevojshme për të qenë në zyrë;
- Sasia e nevojshme e pajisjeve mbrojtëse (maska, doreza, pastrues me bazë alkooli, tretësirë alkooli);
- Dezinfectimi i rregullt i objekteve me tretësira të viricideve;
- Komunikim dhe Ndërgjegjësim i Rregullt duke siguruar informacion të përditësuar për COVID-19.

Efektet afatgjata të situatës aktuale ekonomike janë të vështira për t'u parashikuar dhe pritjet dhe vlerësimet aktuale të drejtimit mund të ndryshojnë nga rezultatet aktuale.

BERDICA CEMENT sh.p.k.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Politikat kryesore kontabël të zbatuara për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, nëse nuk specifikohet ndryshe.

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara të politikave. Gjithashtu, kërkon që Drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave kontabël të shoqërisë. Fushat që kërkojnë një shkallë më të lartë të gjykit apo janë më të ndërlikuara, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë shpjeguar në Shënimin 4.

Monedha funksionale dhe ajo raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë dhe monedha e mjedisit ekonomik kryesor në të cilën Shoqëria kryen veprimtarinë e saj.

Transaksionet në monedhë të huaj: Aktivet dhe detyrimet monetare përkthehen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në fuqi në fund të periudhës raportuese. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhën funksionale të secilës njësi ekonomike në kurset e këmbimit në fund të vitit njihen në fitim ose humbje. Përkthimi në fund të vitit nuk aplikohet për zërat jo monetarë të matura me kosto historike.

Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor që lidhen me huamarrjet dhe paratë dhe ekuivalentët e mjeteve monetare paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse brenda 'Fitim/(humbjet) nga kursi i këmbimit'. Të gjitha fitimet dhe humbjet e tjera nga këmbimi valutor paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse brenda 'Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit'. Përkthimi me kurset e fundvitit nuk zbatohet për zërat jomonetarë që maten me koston historike. Zërat jomonetarë të matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, duke përfshirë investimet e kapitalit neto, përkthehen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në zërat jomonetarë të matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj regjistrohen si pjesë e fitimit ose humbjes nga vlera e drejtë.

Aktivët afatgjatë materiale

Njohja dhe matja. Zërat e aktiveve afatgjatë materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kostoja përfshin shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së aktiveve. Kostot e huamarrjes njihen si shpenzim në periudhën në të cilën ato janë kryer dhe nuk njihen në koston e aktiveve.

Kostot e mëpasshme: Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivit ose njihen si një aktiv i veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me zërin do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e elementit mund të matet me besueshmëri. Kostot e riparimeve të vogla dhe të mirëmbajtjes së përditshme shpenzohen kur ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të pjesëve kryesore ose përbërësve të zërave të aktiveve afatgjatë materiale kapitalizohet dhe pjesa e zëvendësuar regjistrohet.

Amortizimi: Amortizimi përlllogaritet sipas normave më poshtë bazuar në vlerën kontabël neto. Toka dhe aktivet në ndërtim/proces nuk amortizohen.

	<u>Norma e amortizimit</u>
Toka	Nuk amortizohet
Aktive në ndërtim/proces	Nuk amortizohen
Ndertese	5%
Makineri, pajisje	20%
Mjete transporti	20%
Pajisje kompjuterike	25%

BERDICA CEMENT sh.p.k.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Në fund të secilës periudhë raportuese drejtimi i shoqërisë vlerëson nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit të aktiveve afatgjata materiale. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si më e larta e vlerës së drejtë të një aktivi minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerën e tij në përdorim. Vlera kontabël zvogëlohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin në masën që tejkalon tepicën e rivlerësimit të mëparshëm në kapitalin e vet. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme rimerret kur është e përshtatshme, nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit.

Çregjistrimi. Aktivet afatgjata materiale çregjistrohen kur nxirren jashtë përdorimit ose kur nga shitja apo përdorimi i tyre, nuk priten më përfitime ekonomike në të ardhmen. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit apo shitja e aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke iu referuar vlerës së tyre kontabël neto dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultatit operativ për periudhën. Të ardhurat nga shitja e çdo aktivi dhe kostos se këtyre zërave njihet në fitim ose humbje brenda të ardhurave/(shpenzimeve) të tjera të shfrytëzimit.

Aktivët afatgjatë jomateriale

Njohja dhe matja. Zërat e aktiveve afatgjatë jomateriale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kostoja përfshin shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së aktiveve.

Aktivët afatgjatë jomateriale përbëhen nga softëare Financa 5.

Amortizimi: Amortizimi përllogaritet sipas normës 25% bazuar në vlerën kontabël neto.

Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare: Aktivët jomateriale ose aktivët jo-materiale jo të gatshme për përdorim nuk janë subjekt i amortizimit dhe testohen çdo vit për zhvlerësim. Aktivët që janë subjekt i amortizimit rishikohen për zhvlerësim sa herë që ngjarjet ose ndryshimet e rrethanave tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet për shumën me të cilën vlera kontabël e aktivit tejkalon shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme është më e larta mes vlerës së drejtë të një aktivi minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim. Për qëllime të vlerësimit të zhvlerësimit, aktivët grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat ka flukse hyrëse parash të pavarura (njësi gjeneruese të mjeteve monetare). Zhvlerësimet e mëparshme të aktiveve jo-financiare rishikohen për ndryshim të mundshëm në secilën datë raportimi.

Instrumentet financiare – Instrumentat financiarë të Shoqërisë gjatë vitit 2022 dhe 2021 përbëhen nga instrumenta jo-derivativë: të arkëtueshme, huamarrje, mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe llogaritë e pagueshme. Shoqëria nuk ka instrumente financiare të matura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes apo të disponueshme për shitje në datën e raportimit.

Instrumentet financiare – njohja fillestare. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare llogariten në datën e tregtimit, data kur shoqëria angazhohet të blejë apo shesë aktivin. Instrumentat financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit përfshihen për instrumentat që nuk klasifikohen si të mbajtur me vlerë të drejtë.

Instrumentet financiare – matja e mëpasshme.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre. Në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshihen balanca e mjeteve monetare në arkë dhe llogaritë bankare rrjedhëse. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre maten më vonë me kosto të amortizuar minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Llogaritë e arkëtueshme. Llogaritë e arkëtueshme maten më vonë me kosto të amortizuar minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Llogaritë e arkëtueshme me afat të shkurtër nuk aktualizohen.

Huamarrjet. Huamarrjet maten më vonë me kosto të amortizuar.

Llogaritë e pagueshme. Llogaritë e pagueshme maten më vonë me kosto të amortizuar.

BERDICA CEMENT sh.p.k.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Fitimet ose humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivet dhe pasivet financiare të mësipërme cregjistrohen ose zhvlerësohen, si dhe nëpërmjet procesit të amortizimit.

Aktivët financiarë – zhvlerësimi. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që një ose më shumë ngjarje që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, kanë pasur efekt negativ në flukset monetare të cmuara për këtë aktiv.

Vështirësitë financiare të debitorëve, probabiliteti i falimentimit apo riorganizimi financiar i debitorit si dhe mashtimet e gabimet në pagesa, janë disa shembuj treguesish për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Humbja nga zhvlerësimi që lidhet me aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar.

Vlera kontabël neto e aktivit zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie të zbritjes dhe vlera e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi vazhdojnë të llogariten mbi vlerën e mbetur të zvogëluar bazuar në normën fillestare të interesit efektiv. Llogaritë e arkëtueshme së bashku me llogaritë e zbritjes cregjistrohen kur nuk ka perspektivë realiste për rikuperim në të ardhmen.

Në qoftë se në një periudhë të mëvonshme shuma e humbjeve nga zhvlerësimi ulët dhe kjo ulje vjen për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi i njohur në periudhat e mëparshme do të anulohet nëpërmjet rregullimit të llogarisë së zbritjes. Në rast se anulimi rikthehet, shuma njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Aktivët financiarë – fshirja. Aktivët financiarë fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur shoqëria ka kryer cdo përpjekje për rimarrje dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rimarrje. Fshirja përfaqëson një rast të cregjistrimit. Treguesit paraqesin që nuk ka gjasa të ndodhë një rikthim duke përfshirë të gjitha procedurat e ekzekutimit ose kur llogaritë e arkëtueshme shiten në shoqëritë e factoring-ut. Shoqëria mund të fshijë aktivet financiare që janë subjekt i zbatimit me forcë të marrëveshjes kur shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që janë të arkëtueshme sipas termave kontraktuale, megjithatë, nuk ka pritshmëri të arsyeshme për marrjen e tyre.

Aktivët financiarë – ç'regjistrimi. Shoqëria ç'regjistron aktivet financiare kur (a) aktivet shlyhen ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet përfundojnë ose (b) shoqëria ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin e këtyre aktiveve.

Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – ç'regjistrimi. Detyrimet financiare ç'regjistrohen kur ato likuidohen (psh. kur detyrimi i specifikuar në kontratë paguhet, anulohet ose skadon).

Kompesimi i instrumenteve financiare. Aktivët dhe detyrimet financiare kompesohen dhe paraqiten neto në bilanc, vetëm kur ekziston një e drejtë ligjore për kompesimin e shumave të njohura, dhe ekziston qëllimi për shlyerje në baza neto ose realizimin e aktivit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë kompesimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospagimi dhe (iii) në rast mospagimi ose falimentimit.

Qiratë. Kur shoqëria është qiramarrëse në një kontratë qiraje, e cila nuk transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë nga qiradhënësi tek shoqëria, pagesat e përgjithshme të qirasë ngarkohen në fitim ose humbje për vitin në bazë lineare sipas afatit të qirasë.

BERDICA CEMENT sh.p.k.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Kur shoqëria është qiramarrëse në një kontratë qiraje e cila ka transferuar shoqërisë në mënyrë thebësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbi pronësinë, aktivet e marra me qira kapitalizohen në aktivet afatgjata materiale në fillim të qirasë me vlerën më të ulët midis vlerës së drejtë të aktivitetit të marrë me qira dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë. Cdo pagesë e qirasë ndahet mes detyrimit financiar dhe pagesave të interesit në mënyrë që të arrihet një normë konstante në balancën financiare. Kostoja e interesit ngarkohet në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë duke përdorur metodën e interesit efektiv. Aktivet e blera në bazë të qirasë financiare amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër jetës së tyre të dobishme ose me afatit të qirasë, nëse shoqëria nuk është e sigurt se do të marrë pronësinë e aktivitetit në fund të afatit të qirasë.

Kur shoqëria është qiradhënëse në një kontratë qiraje, e cila nuk transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë nga shoqëria te qiramarrësi, pagesat e përgjithshme të qirasë ngarkohen në fitim ose humbje për vitin në bazë lineare afatit të qirasë.

Kur shoqëria është qiradhënëse në një kontratë qiraje e cila ka i transferuar qiramarrësit në mënyrë thebësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbi pronësinë, aktivet e dhëna me qira regjistrohen dhe njihet një e drejtë e arkëtueshme nga qiraja në fillim të qirasë me vlerën aktuale të shumave të qirasë. Cdo arkëtim i qirasë ndahet mes të drejtës së arkëtueshme dhe të ardhurave të interesit. Të ardhurat e interesit ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Tatimi mbi fitimin. Tatimi mbi fitimin është paraqitur në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi ose që konsiderohet i tillë në fund të periudhës raportuese. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë dhe njihet në të ardhura dhe shpenzime për vitin, përveçse në rastin kur njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse drejtpërdrejt në kapital sepse lidhet me transaksionet që njihen gjithashtu, në të njëjtën ose në një tjetër periudhë, në të ardhura të tjera përmbledhëse ose në kapital.

Tatimi aktual është shuma që pritet të paguhet ose të rimburohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat e tanishme dhe të mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësimet nëse pasqyrat financiare janë të autorizuar përpara se të dorëzohen deklaratat përkatëse tatimore. Tatimet e tjera përveç tatimit mbi fitimin regjistrohen si shpenzime operative.

Tatim fitimi i shtyrë llogaritet për humbjet tatimore që mbarten dhe diferencat e përkohshme që lindin midis bazës tatimore të aktiveve dhe pasiveve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar. Në përputhje me përjashtimin fillestar të njohjes, tatimet e shtyra nuk regjistrohen për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të një aktivi ose një pasivi në një transaksion tjetër nga një kombinim biznesi nëse transaksioni, kur regjistrohet fillimisht, nuk ndikon në asnjë llogari, as fitim të tatueshëm. Gjendjet tatimore të shtyra maten me normat e tatimit të miratuara ose të vendosura në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të zbatohen në periudhën kur do të ndryshojnë diferencat e përkohshme ose do të përdoret humbja tatimore.

Aktivitetet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet tatimore që mbarten në të ardhmen regjistrohen vetëm deri në masën që është e mundur që diferenca e përkohshme të kthehet në të ardhmen dhe ekziston fitim i mjaftueshëm i ardhshëm i tatueshëm në të cilin mund të shfrytëzohen zbritjet.

Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e aktiveve tatimore aktuale kundrejt detyrimeve tatimore aktuale dhe kur aktivitetet dhe detyrimet e tatimit mbi të ardhurat e shtyra kanë të bëjnë me tatimet mbi të ardhurat e mbledhura nga i njëjti autoritet tatimor ose autoritete të ndryshme ku ka një qëllim për të shlyer gjendjet në baza neto.

Inventarët. Inventarët maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet mbi bazën mesatare të ponderuar. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën e zakonshme të biznesit, minus koston e vlerësuar të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Parapagimet. Parapagimet njihen me kosto minus provizionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti ose kur parapagimi lidhet me një aktiv që vetë klasifikohet si afatgjatë pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e aktiveve transferohen në vlerën kontabël neto të aktivit sapo shoqëria ka marrë kontrollin e aktivit dhe është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me aktivin do të rrjedhin në shoqëri. Pagesat paraprake të tjera shënohen në fitim ose humbje kur merren mallrat/shërbimet që lidhen me parapagimet.

Nëse ka një indikacion se aktivet, mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin nuk do të pranohen, vlera e mbartur e parapagimit shlyhet në përputhje me rrethanat dhe një humbje përkatëse e zhvlerësimit njihet në të ardhurat dhe shpenzimet e vitit.

Dividendët. Dividendët regjistrohen si detyrim dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe para se pasqyrat financiare të autorizohen për t'u lëshuar, shpalosen si ngjarje pas periudhës raportuese por të cilat nuk janë rregulluese.

Njohja e të ardhurave. Të ardhurat i përkasin aktiviteteve të zakonshme të Shoqërisë. Të ardhurat njihen në shumën e çmimit të transaksionit. Çmimi i transaksionit është shuma të cilën Shoqëria pret t'i përkasi në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat e premtuara për një klient, duke përjashtuar shumat e mbledhura në emër të palëve të treta.

Të ardhurat njihen neto nga uljet, kthimet dhe taksat e vlerës së shtuar, pagesa të tjera të ngjashme të detyrueshme.

Të ardhurat njihen kur kontrolli i mallrave është transferuar, duke qenë kur mallrat i dorëzohen klientit, klienti ka diskrecion të plotë mbi mallrat dhe Shoqëria nuk ka asnjë detyrim të paplotësuar që mund të ndikojë në pranimin e mallrave nga klienti. Dorëzimi ndodh kur mallrat janë dërguar në vendin e caktuar, rreziku i vjetërsimit dhe humbjes i është transferuar klientit dhe/ose klienti ka pranuar mallrat në përputhje me kontratën, dispozitat e pranimin kanë skaduar, ose Shoqëria ka dëshmi objektive që të gjitha kriteret për pranim janë përmbushur.

Nëse të ardhurat nga mallrat e shitura nga Shoqëria tejkalojnë pagesën, njihet një e drejtë e arkëtueshme. Nëse pagesat tejkalojnë të ardhurat nga mallrat e shitura, njihet një detyrim Arkitime ne avance per porosi.

Përfitimet e punonjësve Gjatë aktivitetit normal të biznesit, shoqëria kryen pagesa kontributesh për llogari të saj dhe të punonjësve për të kontribuar në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e kryera për llogari të shoqërisë në këtë skemë me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

BERDICA CEMENT sh.p.k.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

4. Vlerësime të rëndësishme të kontabilitetit dhe gjykime në zbatimin e politikave kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen mbi bazën e parimit të vijimësisë. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim domethënës në vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale. Vlerësimi i jetës së dobishme të zërave të aktiveve afatgjata materiale është çështje e gjykimit bazuar në përvojën me aktive të ngjashme. Përfitimet ekonomike të ardhshme të aktiveve konsumohen kryesisht përmes përdorimit. Megjithatë, faktorë të tjerë, siç janë vjetërsia teknike dhe komerciale dhe konsumimi, shpesh rezultojnë në zvogëlimin e përfitimeve ekonomike të mishëruara në aktive. Drejtimi vlerëson jetën e dobishme të mbetur në përputhje me kushtet aktuale teknike të aktiveve dhe periudhën e vlerësuar gjatë së cilës pritet që asetet të fitojnë përfitime për Shoqërinë. Janë konsideruar faktorët kryesorë në vijim: (a) përdorimi i pritur i aktiveve dhe zhvillimet e nevojshme teknologjike; (b) vlera e pritshme e demtimit nga përdorimi, i cili varet nga faktorët operacionalë dhe programi i mirëmbajtjes; dhe (c) vjetërsimi teknik ose komercial që rrjedh nga ndryshimet në kushtet e tregut dhe nevojat e klientit për performance absolute.

Politika e fshirjes. Aktivet financiare fshihen, tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka shteruar të gjitha përpjekjet praktike për rikuperim dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme rikuperimi. Përcaktimi i flukseve monetare për të cilat nuk ka pritshmëri të arsyeshme rikuperimi kërkon gjykim. Drejtimi mori në konsideratë treguesit e mëposhtëm se nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperim: të arkëtueshmet tregtare të vonuara mbi 3 vjet, procedurat e likuidimit ose falimentimit.

BERDICA CEMENT sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

5. Të ardhurat

Të ardhurat operative për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2022 në shumën prej 2,962,306,079 Lekë (2021: 1,679,632,413 Lekë) gjenerohen nga shitja e mallrave të ndryshëm industrial të përdorur në ndërtim si çimento, gëlqere, gur kuarci, rezinë dhe nga shërbimet e transportit.

Të ardhurat njihen në një moment kohor që është momenti i transferimit të risqeve dhe përfitimeve.

	2022	2021
Të ardhura nga shitja e mallrave	2,960,336,973	1,679,354,951
Të ardhura nga shërbimi transportit	1,969,106	144,507
Komisione	-	132,954
	2,962,306,079	1,679,632,413

6. Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera janë të përbëra nga elementët e mëposhtëm:

	2022	2021
Shpenzime qira	22,740,629	15,076,493
Shpenzime mirëmbajtje	14,402,732	7,859,085
Shpenzime siguracioni	3,003,420	2,444,428
Shpenzime karburanti	49,131,415	24,008,380
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimi aktiveve	6,192,882	2,218,273
Shpenzime shëbime doganore	5,417,827	7,945,879
Shërbime utilitare	3,770,737	2,981,904
Fitim nga kembimet valutore*	(15,455,117)	-
Shpenzime udhetime dhe dieta	14,493,711	3,236,770
Shërbime bankare	3,558,634	2,434,342
Shërbime auditimi	480,000	300,000
Shërbime portuale	1,013,459	-
Zhvlerësimi të arkëtueshme tregtare	501,831	-
Te tjera	13,761,637	17,645,846
	123,013,796	86,151,401

*Fitimet nga humbjet valutore përfshijnë diferencat e këmbimit nga të gjithë zërat monetarë me përjashtim të mjeteve monetare dhe huamarrjeve. Këto të fundit paraqiten në zërin Fitim/(humbjet) nga kursi i këmbimit.

7. Shpenzimet personeli

Shpenzimet e personelit janë të përbëra nga elementët e mëposhtëm:

	2022	2021
Shpenzime paga	43,670,567	31,880,243
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të detyrueshme	6,955,227	5,116,349
	50,625,794	36,996,592

8. Shpenzime tatim fitimi

(a) Komponentët e shpenzimit të tatim fitimit

Shpenzimi për tatim fitimin paraqiten si në vijim:

	2022	2021
Tatim fitimi i vitit aktual	25,819,310	19,240,444
Tatim fitimi i shtyrë	-	-
Totali	25,819,310	19,240,444

BERDICA CEMENT sh.p.k.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022**

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

8. Shpenzime tatim fitimi (vazhdim)**(b) Rakordimi ndërmjet shpenzimeve tatimore dhe fitimit ose humbjes shumëzuar me normën e aplikueshme tatimore**

Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 15% (2021: 15%). Rakordimi i shpenzimit për tatimin mbi fitimin me shumën e përcaktuar nga zbatimi i normës tatimore mbi fitimin në Shqipëri, është përmbledhur si në vijim.

	2022	2021
Fitimi/(Humbja) para tatimit	163,733,197	122,743,510
Tatimi mbi fitimin duke përdorur normën ligjore prej 15%	24,559,980	18,411,527
Efekti i tatimit mbi zërat e pazbritshëm për qëllime taksimi:		
- Shpenzime jo të zbritshme	1,259,330	828,918
Tatimi mbi fitimin për shkak të pozicioneve tatimore të pasigurta të periudhave të mëparshme	-	-
Totali	25,819,310	19,240,444

(c) Tatim fitimi i pagueshëm

Lëvizjet në tatim fitimin e Shoqërisë për vitin 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

	2022	2021
Balanca çelëse	2,843,074	-
Detyrim i periudhës	25,819,310	19,240,444
Parapagime të periudhës	(23,743,049)	(16,397,370)
Pagesa tatim fitimi	(2,843,074)	0
Te tjera	-	-
Totali	2,076,261	2,843,074

BERDICA CEMENT sh.p.k.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

9. Aktivet afatgjata materiale

	Aktive ne proces	Ndertesa	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Pajisje zyre	Pajisje informatike	Totali
Kosto me 1 Janar 2022	-	66,927,029	31,048,975	64,522,103	2,328,109	3,762,753	168,588,970
Amortizimi i akumuluar	-	(12,951,876)	(15,007,643)	(37,494,395)	(1,655,119)	(1,770,107)	(68,879,139)
Vlera kontabël neto 1 Janar 2022	-	53,975,153	16,041,332	27,027,709	672,991	1,992,646	99,709,830
Shtesa	30,504,259	506,378	7,324,445	5,630,247	1,683,825	231,417	45,880,570
Pakesime	-	-	-	(5,891,307)	-	(301,575)	(6,192,882)
Shpenzimi amortizimit	-	(2,700,868)	(3,759,687)	(5,960,184)	(352,678)	(447,004)	(13,220,421)
Vlera kontabël neto 31 Dhjetor 2022	30,504,259	51,780,663	19,606,091	20,806,464	2,004,137	1,475,483	126,177,097
Kosto me 31 Dhjetor 2022	30,504,259	67,433,407	38,373,420	64,261,043	4,011,934	3,692,594	208,276,657
Amortizimi i akumuluar	-	(15,652,744)	(18,767,329)	(43,454,579)	(2,007,797)	(2,217,111)	(82,099,560)
Vlera kontabël neto 31 Dhjetor 2022	30,504,259	51,780,663	19,606,091	20,806,480	2,004,137	1,475,483	126,177,112

10. Aktivet afatgjata jomateriale

	Software
Kosto me 1 Janar 2022	216,856
Amortizimi i akumuluar	-
Vlera kontabël neto 1 Janar 2022	216,856
Shtesa	24,000
Pakesime	-
Shpenzimi amortizimit	(57,214)
Vlera kontabël neto 31 Dhjetor 2022	183,642
Kosto me 31 Dhjetor 2022	240,856
Amortizimi i akumuluar	(57,214)
Vlera kontabël neto 31 Dhjetor 2022	183,642

11. Llogaritë e arkëtueshme

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Kliente	324,283,917	257,236,704
Minus: Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	(501,831)	-
	323,782,086	257,236,704

BERDICA CEMENT sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

11. Llogaritë e arkëtueshme (vazhdim)

Përqëndrimi gjeografik i llogarive të arkëtueshme në datën e raportimit është si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Vendase	285,166,924	214,723,018
Vendet e tjera	38,615,162	42,513,685
Totali	323,782,086	257,236,704

Lëvizjet në zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme për vitin 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

	2022	2021
Balanca çelëse	-	-
Shpenzimi zhvlerësimit periudhës	501,831	-
Rimarrje zhvlerësimi	-	-
Totali	501,831	-

Gjatë vitit 2022 dhe 2021, Shoqëria nuk ka fshirë asnjë të arkëtueshme tregtare.

12. Të tjera të arkëtueshme

Vlera të tjera të arkëtueshme përbëhet si më poshtë:

	2022	2021
TVSH e zbritshme	50,925,845	32,927,207
Parapagime taksa doganore	292,276	429,674
Të drejta ndaj punonjësve	51,106	-
Parapagim i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	-	932,550
Totali	51,269,227	34,289,431

13. Mjete monetare

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Mjete monetare në arkë	938,106	2,794,140
<i>Mjete monetare në bankë</i>		
Llogari rrjedhëse në Lek	801,089	5,092,916
Llogari rrjedhëse në monedhë të huaj	6,732,061	19,848,808
	7,533,150	24,941,724
Mjete monetare	8,471,256	27,735,864

Mjetet monetare në 31 dhjetor 2022 dhe 2021 nuk janë zhvlerësuar.

14. Inventarët

2022	2021
------	------

BERDICA CEMENT sh.p.k.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022***(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)*

Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	-	380,383
Mallra për rishitje	350,299,404	212,690,770
Totali	350,299,404	213,071,153

Kostoja e inventarëve e njohur si shpenzim gjatë periudhës që përfaqëson koston e shitjeve është në shumën 2,605,587,696 Lek (2021: 1,421,273,323 Lek).

Gjatë vitit 2022, Shoqëria nuk ka njohur ndonjë zhvlerësim ose rimarrë ndonjë shumë zhvlerësimi.

Në 2022, inventarët janë vlerësuar me kosto (2021: njëjtë). Shoqëria nuk ka inventarë të vlerësuar me vlerën neto të realizueshme.

15. Kapitali

Në 31 dhjetor 2022 kapitali aksionar i Shoqërisë është 130,755,000 Lekë, i përbërë nga 2 pjesë të zotëruara nga ortakët Behar Bërdica me vlerë 66.685.050 Lek dhe nga ortakët Zyhdri Reshketa me vlerë 64.069.950 Lek. Kapitali është paguar plotësisht.

Ortakët e shoqërisë kanë të drejtë të marrin dividend në rastin kur ato janë deklaruar.

16. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të pagueshme tregtare	408,292,312	232,958,754
Të pagueshme ndaj punonjësve	-	26,800
Dividend i pagueshëm	72,488,371	-
	480,780,683	232,985,554

17. Tatime të pagueshme

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,039,886	810,743
Tatimi mbi të ardhurat personale	347,248	268,557
Tatim në burim	266,238	110,750
Tatim fitimi	2,076,261	2,843,074
	3,729,632	4,033,124

18. Huamarrjet

Huamarrjet afatshkurtra dhe afatgjata përbëhen nga kredi me termat si më poshtë:

1. Kontratë kredie me OTP bank në vlerë 1,500,000 Euro lëvruar në 2022 me maturitet 61 muaj
2. Kontratë kredie me OTP bank në vlerë 61,465,936.9 Lekë me maturitet 45 muaj me normë interesi 4.81%
3. Overdraft në Raiffeisen Bank në monedhën Eur me maturitet 12 muaj
4. Kartë krediti me Raiffeisen bank në monedhën Eur

Tabela më poshtë pasqyron lëvizjet në huamarrjet afatshkurtra dhe afatgjata gjatë 2022:

Huamarrje afatshkurtra dhe afatgjata 1 Janar 2022	192,398,956
<i>Flukse monetare</i>	
Arkëtime huaje	114,598,200
Pagesë huaje	(124,328,753)
Pagesë interesi	(8,137,758)
<i>Flukse jo-monetare</i>	
Shpenzime interesi	8,137,758
Diferenca nga këmbimet valutore	(240,800)

BERDICA CEMENT sh.p.k.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022**

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

Balanca 31 dhjetor 2022	182,427,606
--------------------------------	--------------------

19. Qira financiare

Në 2020, Shoqëria ka marrë një mjet transporti me qira financiare me maturitet 60 muaj. Aktivi është njohur në aktivet afatgjata brenda klasës Mjete transporti.

Tabela më poshtë pasqyron lëvizjet në qiranë e pagueshme gjatë 2022:

Qira pagueshme 1 Janar 2022	2,222,060
<i>Flukse monetare</i>	
Pagesë qiraje financiare	(648,624)
<i>Flukse jo-monetare</i>	
Diferenca nga këmbimet valutore	(97,273)
Balanca 31 dhjetor 2022	1,476,162

20. Menaxhimi i rrezikut financiar

Menaxhimi i rrezikut brenda Shoqërisë monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar, rrezikun operacional dhe rrezikun ligjor. Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (rreziku i monedhës, rreziku i normave të interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Objektivat kryesore të funksionit të administrimit të rrezikut financiar janë vendosja e kufijve të rrezikut dhe më pas sigurimi që ekspozimi ndaj rreziqeve të mbetet brenda këtyre kufijve. Funksionet e menaxhimit të rrezikut operacional dhe ligjor kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme, në mënyrë që të minimizohen rreziqet operationale dhe ligjore.

Rreziku i kredisë. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, i cili është rreziku që një palë e instrumentit financiar do të shkaktojë humbje financiare për palën tjetër duke mos përmbushur detyrimet që i takojnë.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë vjen si rezultat i transaksioneve me palët e tjera, duke sjellë kështu angazhime të aktiveve financiare dhe atyre jashtë bilanci. Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë sipas grupit të aktiveve pasqyrohet në vlerën kontabël të aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar.

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë si më poshtë:

	2022	2021
Te arketueshme tregtare	323,782,086	257,236,704
Të drejta ndaj punonjësve	51,106	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	8,471,256	27,735,864
Totali	332,304,447	284,972,568

Rreziku i likuiditetit. Rreziku i likuiditetit është rreziku që një shoqëri do të ketë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj kërkesave të përditshme në burimet e mjeteve monetare. Rreziku i likuiditetit menaxhohet nga Departamenti i Financës të Shoqërisë. Drejtimi monitoron çdo muaj parashikimet e flukseve monetare të Shoqërisë nëpërmjet Departamentit të Financës.

Shoqëria kërkon të mbajë një bazë të qëndrueshme të financimit, e cila kryesisht përbëhet nga të pagueshme tregtare dhe të tjera. Portofoli i likuiditetit të Shoqërisë përfshin mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre (Shënimi 13). Drejtimi vlerëson se paratë e portofolit të likuiditetit mund të realizohen me para në një kohë të arsyeshme për të përmbushur kërkesat e parashikuara të likuiditetit.

BERDICA CEMENT sh.p.k.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

Pozicioni i likuiditetit monitorohet dhe testimi i stresit të likuiditetit bëhet rregullisht nën skenarë të ndryshëm që mbulon kushte normale dhe më të rënda të tregut.

Tabela më poshtë tregon detyrimet në 31 dhjetor 2022 dhe 2021 nga afati kontraktual i mbetur. Shumat e shpalosura në tabelën e maturimit janë flukset monetare kontraktuale të paskontuara, të pagueshme tregtare dhe detyrimet e tjera financiare. Flukset e tilla të mjeteve monetare të paskontuara ndryshojnë nga shuma e përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar sepse vlera në pasqyrën e pozicionit financiar bazohet në flukset monetare të skontuara.

Kur shuma e pagueshme nuk është fikse, vlera në informacionin shpjegues përcaktohet duke iu referuar kushteve që ekzistojnë në fund të periudhës së raportimit. Pagesat në valutë të huaj janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në fund të periudhës raportuese.

Vlerat në maturim të paskontuara të detyrimeve financiare sipas kontratave janë si më poshtë:

31 dhjetor 2022	Vlera e mbartur	Totali	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 vit deri në 5 vite	Më shumë se 5 vite
Huamarrje afatshkurtra	86,703,563	86,703,563	-	-	86,703,563	-	-
Huamarrje afatgjata	95,724,043	95,724,043	-	-	-	95,724,043	-
Qira e pagueshme afatshkurtër	617,615	617,615	-	-	617,615	-	-
Qira e pagueshme afatgjatë	858,547	858,547	-	-	-	858,547	-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe te tjera	480,780,683	480,780,683	-	-	480,780,683	-	-
Totali	664,684,452	664,684,452	-	-	568,101,862	96,582,590	-

31 dhjetor 2021	Vlera e mbartur	Totali	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 vit deri në 5 vite	Më shumë se 5 vite
Huamarrje afatshkurtra	81,982,289	81,982,289	-	-	81,982,289	-	-
Huamarrje afatgjata	110,416,667	110,416,667	-	-	-	110,416,667	-
Qira e pagueshme afatshkurtër	748,185	748,185	-	-	748,185	-	-
Qira e pagueshme afatgjatë	1,473,875	1,473,875	-	-	-	1,473,875	-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe te tjera	232,985,554	232,985,554	26,800	-	232,958,754	-	-
Totali	427,606,569	427,606,569	26,800	-	315,689,228	111,890,541	-

Rreziku i tregut. Rreziqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në (a) monedhë, (b) normat e interesit dhe (c) produkte të kapitalit, të cilat janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës. Drejtimi vendos kufij mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, i cili monitorohet çdo ditë. Sidoqoftë, përdorimi i kësaj qasje nuk parandalon humbje jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të rëndësishme të tregut.

Rreziku i monedhës. Në lidhje me rrezikun e monedhës, drejtimi vendos kufij në nivelin e ekspozimit sipas monedhës dhe në total për pozicionet brenda natës dhe brenda ditës, të cilat monitorohen çdo ditë.

Tabela e mëposhtme është një përmbledhje e ekspozimit të Shoqërisë ndaj rrezikut të monedhës nga këmbimi valutator në fund të periudhës raportuese:

	Vlera e mbartur	EUR	USD	ALL	CHF
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	8,471,256	7,064,878	200,550	1,205,829	-
Të arkëtueshme tregtare	323,782,086	148,462,615	-	175,319,470	-
Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	408,292,312	353,339,848	-	54,951,963	-
Qira e pagueshme	1,476,162	1,476,162	-	-	-
Huamarrjet	182,427,606	98,116,944	-	84,310,662	-
Ekspozimi neto 31 dhjetor 2022	924,449,422	608,460,447	200,550	315,787,925	0

BERDICA CEMENT sh.p.k.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe

Kurset kryesore të këmbimit të përdorura gjatë vitit:

Në Lekë

	Kursi në datën e raportimit	
	2022	2021
USD	107.05	106.54
EURO	114.23	120.76

BERDICA CEMENT sh.p.k.**SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE - 31 DHJETOR 2022**

(Të gjitha shumat janë shprehur në lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

Tabela e mëposhtme paraqet ndjeshmërinë e fitim/humbjes ndaj ndryshimeve të arsyeshme dhe të mundshme të kurseve të këmbimit në fund të periudhës raportuese në krahasim me monedhën funksionale të Shoqërisë, duke mbajtur konstantë faktorët e tjerë.

	Fitim ose humbje	
	Forcim	Dobësim
31 dhjetor 2022		
EUR (5% lëvizje)	30,423,022	(30,423,022)
USD (5% lëvizje)	10,027	(10,027)

	Fitim ose humbje	
	Forcim	Dobësim
31 dhjetor 2022		
EUR (10% lëvizje)	60,846,045	(60,846,045)
USD (10% lëvizje)	20,055	(20,055)

Rreziqe të tjera të çmimit. Shoqëria nuk ka ekspozim ndaj rrezikut të çmimit të kapitalit.

21. Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Shoqërisë për menaxhimin e kapitalit janë të mbrojnë aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë në mënyrë që të sigurojë kthimin për ortakët dhe përfitimet për palët e tjera të interesit dhe për të ruajtur një strukturë optimale të kapitalit për të ulur koston e kapitalit. Për të ruajtur ose rregulluar strukturën e kapitalit, Shoqëria mund të rregullojë shumën e dividendëve të paguar ndaj ortakëve, të kthejë kapitalin tek ortakët, të emëtojë pjesë të reja.

22. Balanca dhe transaksione me palët e lidhura

Palët konsiderohen të lidhura nëse janë nën kontroll të përbashkët ose nëse njëra palë ka aftësinë të kontrollojë palën tjetër ose mund të ushtrojë influencë të konsiderueshme ose kontroll të përbashkët mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative. Në shqyrtimin e secilës marrëdhënie të mundshme të palëve të lidhura, vëmendja shkon ndaj përmbajtjes së marrëdhënies, jo thjesht formës juridike.

Shpërblimi i personelit kryesor të drejtimit

Pagesa totale, tarifa të tjera për administratoret përfshihen në shpenzimet e personelit:

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
<u>Shpenzime personeli</u>		
Shpenzime paga	2,691,499.0	1,521,360.0
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të detyrueshme	331,132.0	424,464.0
<u>Totali</u>	<u>3,022,631</u>	<u>1,945,824</u>

23. Angazhime dhe aktive / detyrime të kushtëzuara**24. Ngjarje pas datës së raportimit**

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që do të kërkojnë rregullime ose shënime shpjeguese shtesë në këto pasqyra financiare.

